



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE**

**RREGULLORE**

**PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË  
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË ENTIN KOMBËTAR TË  
BANESAVE**

**KREU I  
RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Baza ligjore**

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit në ILDKPKI, bazohet në ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

**Neni 2  
Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave, mënyrave, procedurave, përgjegjësi dhe kompetencave për zbatimin e detyrimeve ligjore për deklarimin e pasurisë dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesit.

**Neni 3  
Përkufizime**

- “Zyrtar” është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në EKB.

-“Personi i lidhur me një zyrtar” është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasuror ose vetjak jo pasuror me zyrtarin, sipas përcaktimit të pikës 11, të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

- “Subjekt deklarues” është çdo person, që ka detyrimin e deklarimit sipas nenit 3 të Ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003 “ Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënprunësve publikë”.

- “Autoritet Përgjegjës” për parandalimin e Konfliktit të Interesave në çdo institucion publik është struktura përgjegjëse, e cila ndjek në vazhdimësi procesin e deklarimit të pasurisë dhe interesave private, për të gjithë zyrtarët e institucionit publik përkatës, duke hartuar dhe përditësuar listën e zyrtarëve, të cilët në varësi të funksionit që kryejnë, mbartin detyrimin për deklarim të interesave private. Autoriteti Përgjegjës menaxhon procesin e deklarimit në sistem të subjekteve deklaruese, sipas legjislacionit në fuqi dhe udhëzimit Nr.927, datë 01.11.2021.

- “Konflikt rast për rast” interesi është gjendja, me konflikt interesi që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë

- “Konflikt faktik” i interesit është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit.

- “Konflikt në dukje” i interesit është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit duken në pamje ose në formë sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të zyrtarit, por në fakt ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

- “Konflikti i mundshëm” i interesit është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari përfshihet në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

### **Neni 3/1**

**1.** Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji në EKB janë:

- a.** Autoritet përgjegjës në EKB, është Drejtori i Përgjithshëm.
- b.** Zyrtari përgjegjës në EKB, është Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse.

**2.** Institucionet e varësisë janë:

- a.** Degët rajonale të EKB-së.

Për institucionet e varësisë që nuk kanë ngritur strukturë përgjegjëse, detyrimet ligjore do të ndiqen dhe zbatohen nga Autoriteti përgjegjës i EKB-së, i cili kryen detyrat e ngarkuara nga Inspektori i Përgjithshëm.

## **KREU II DEKLARIMI I PASURISË**

### **Neni 4 Autoriteti Përgjegjës**

1. Autoriteti përgjegjës në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04 2005, i ndryshuar, është i autorizuar që në mënyrë aktive në emër të EKB-së:

1. të mbledhë nga burime të ligjshme informacione, të dhëna për interesat private të një zyrtari;
2. të pranojë informacionet e siguruar në mënyrë të ligjshme;
3. të verifikojë besueshmërinë e këtyre informacioneve;
4. të bëjë me dije zyrtarin, për informacionet e siguruar për të;
5. t'i japë mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë.
6. Të bëjë regjistrimin e interesave private të zyrtarit:
  - a) jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në institucion të njoftojë zyrtarin, i cili është i detyruar të lëshojë autorizim, në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit e autorizon këtë institucion të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar, autorizim i cili ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.
  - b) Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti interesi rast për rast, regjistrohet identiteti i zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi, thelbi i konfliktit, palët e interesuara, burimi i të dhënave, mënyra e marrjes dhe verifikimit të tyre, si dhe vendimi që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose gjykatat.
7. Të ndjek procedurat për plotësimin dhe dorëzimin brenda afateve kohore të caktuara, të formularëve të deklarimit të pasurisë, për zyrtarët që përmbushin detyrimin sipas ligjit në fuqi.
8. Ndjek mbarëvajtjen e plotësimit dhe dorëzimit në afate kohore të caktuara të formularëve të vetëdeklarimit, sipas ligjit Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për drejtuesit e të gjitha niveleve.

## **Neni 5**

### **Subjektet që mbartin detyrimet për deklarimin**

Mbartin detyrimin për deklarim periodik në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

1. Drejtori i Përgjithshëm
2. Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm
3. Drejtorët e Degëve Rajonale

## **Neni 5/1**

### **Subjektet deklaruese:**

- a) mbajnë përgjësi për aprovimin e versionit përfundimtar brenda afateve të përcaktuara në ligj e në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

- b) dorëzojnë të nënshkruar, në formë shkresore, deklaratën e interesave private të përfunduar pranë Autoritetit Përgjegjës.
- c) bashkëpunojnë me ILDKPKI, gjatë procedurave të kontrollit të plotë dhe/ose hetimit administrativ.

## **Neni 6**

### **Afati i deklaramit**

#### **Subjektet deklaruese duhet të plotësojnë deklaratat e interesave private përkatëse, sipas mënyrës dhe afateve të mëposhtme:**

- a) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklaramin periodik vjetor të interesave private dhe konfliktit të interesave, duhet të plotësojnë deklaratën periodike vjetore në funksion, për pasuritë e akumuluar ndër vite dhe detyrimet financiare me gjendje deri në fund të vitit deklarues, si dhe burimin e krijimit të tyre. Deklarata e interesave periodike vjetore në formë elektronike, për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, si vijon:
  - në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS sipas Udhëzimit Nr.927 datë 01.11.2021, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI,
  - në formë shkresore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të Entit Kombëtar të Banesave.
- b) Subjektet të cilët fillojnë marrëdhëniet e punës pas datës 1 Janar, mbartin detyrimin të bëjnë deklaramin para fillimit të detyrës dhe duhet të kryejnë deklaramin në sistemin EACIDS, sipas Udhëzimit Nr.927 datë 01.11.2021, brenda 30 ditëve nga fillimi i detyrës në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:
  - në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS sipas Udhëzimit Nr.927 datë 01.11.2021, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI,
  - në formë shkresore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të Entit Kombëtar të Banesave.
- c) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklaramin periodik vjetor të interesave private dhe konfliktit të interesave, duhet të kryejnë deklaramin në sistemin EACIDS, brenda datës 31 Mars të çdo viti, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:
  - në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS sipas Udhëzimit Nr.927 datë 01.11.2021, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI,

- në formë shkresore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të Entit Kombëtar të Banesave.
- d) Subjektet të cilët largohen nga detyra pas datës 01 Janar, mbartin detyrim të bëjnë deklarinim pas largimit nga funksioni dhe duhet të kryejnë deklarinim në sistemin EACIDS, brenda 15 ditëve nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:
  - në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS sipas Udhëzimit Nr.927 datë 01.11.2021, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI,
  - në formë shkresore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të Entit Kombëtar të Banesave.
- e) Subjektet të cilët mbartin detyrim ligjor të bëjnë deklarinim me kërkesë të interesave private, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave private me kërkesë, në formë elektronike, në sistemin EACIDS, jo më vonë se 30 ditë nga data që Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI kërkon kryerjen e deklarinimit me kërkesë, në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si vijon:
  - në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS sipas Udhëzimit Nr.927 datë 01.11.2021, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI,
  - në formë shkresore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të Entit Kombëtar të Banesave.

## **Neni 7**

### **Objekt i deklarinimit**

Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqindmijë) lekë;
- d) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- e) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

- f) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- g) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- h) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.
- i) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;
- j) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;
- k) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;
- l) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.
- m) Interesat privatë të llojeve të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji mund të kërkohen të deklarohen periodikisht, nëse kjo është e mundur dhe e përshtatshme për nënloje interesash brenda këtyre llojeve, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.

## **Neni 8**

### **Dorëzimi i deklaratave të interesave private**

1. Të gjitha subjektet e ligjit dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarim, detyrohen të plotësojnë deklaratën e tyre në formë elektronike me mjetet e komunikimit elektronik, të vëna në dispozicion nga Inspektorati i Lartë dhe ta paraqesin personalisht, në formë shkresore, të mbyllur në zarf në strukturat përkatëse të institucioneve, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj për të gjitha llojet e deklarimit.
2. Nëse dorëzimi bëhet personalisht në strukturat përkatëse të institucioneve, pasqyrohet në një procesverbal, që përfshin të dhënat për identifikimin e deklaratës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi.
3. Deklarata e dërguar me mjete të komunikimit elektronik konsiderohet e marrë me plotësimin dhe dërgimin në sistemin e deklarimit me mjetet elektronike.
4. Subjektet, të cilët nuk janë zyrtarë në momentin e dorëzimit të deklaratës, e dorëzojnë atë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas përcaktimeve të këtij neni, përveç kur parashikohet ndryshe.

## **Neni 9**

### **Refuzimi për deklarim**

1. Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. Inspektori i Përgjithshëm, brenda 30 ditëve, i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për largimin nga puna të personit që refuzon të deklarojë.  
Organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna të punonjësit që ka refuzuar deklarimin.
2. Kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur ose nga ata me imunitet, Inspektori i Përgjithshëm vë në dijeni Kuvendin dhe, kur është rasti, edhe organin epror të personit.  
Në të gjitha rastet e refuzimit të deklarimit, me kalimin e 30 ditëve nga njoftimi i organit përgjegjës, Inspektori i Përgjithshëm detyrohet t'i bëjë publike rastet e refuzimit të deklarimit.

### **Neni 10**

#### **Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave private (para fillimit të punës, vjetor, dhe pas largimit nga funksioni).**

Bazuar ne nenin 3 të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 dhe në nenet 27 deri 33 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 i ndryshuar, nga Autoriteti Përgjegjës i EKB-së bëhet regjistrimi i zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim periodik të interesave në regjistrin themeltar, sipas formatit nr. 2, datë 13.01.2004, të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.

### **KREU III**

#### **KONFLIKTI I INTERESAVE**

### **Neni 11**

#### **Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konfliktit rast për rast**

1. Zyrtarët që do të plotësojnë autorizim për verifikim të të dhënave të tyre vetjake kudo ku ato janë regjistruar do të jenë:
  - Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së,
  - Zv. drejtori i Përgjithshëm i EKB-së,
    - Për autoritetin përgjegjës të vetë institucionit, në kushtet e EKB-së, zyrtarët që do të plotësojnë autorizim për verifikim të të dhënave të tyre vetjake, kudo ku ato janë regjistruar, do të jenë:
      - Drejtor i Degës Rajonale të EKB-së,
2. Në kushtet e EKB-së kuptimi i vendimmarrjes për një akt dhe kompetencës thelbësore e përcaktuese të një zyrtari sipas parimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 4 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e EKB-së.
3. Në kushtet e Entit Kombëtar të Banesave, nënlojet e interesave ose interesa konkrete që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave, si dhe masa e kufizimit të tyre janë:
  - Lidhja e kontratave,
  - Miratimi i kredive për shtëpi banimi,

- Pjesëmarrja në prokurimin e fondeve,
  - Pjesëmarrja në ushtrimin e kontrollit të brendshëm.
4. Procesi i identifikimit dhe regjistrimit të interesave private të zyrtarëve, të lidhur me konfliktin rast për rast të interesit në EKB do të realizohet si vijon:
- Nëpërmjet vetë deklaramit të zyrtarit, rast pas rasti të ekzistencës së interesave të tij private që mund të bëhen shkak për konflikt interesash;
  - Nëpërmjet informacionit të interesave private të zyrtarit nga persona të tretë;
  - Nëpërmjet burimeve të tjera informacioni për interesa private të zyrtarit (media, shtypi i shkruar apo çdo burim tjetër i ligjshëm).
5. Çdo zyrtar apo subjekt që ofron informacion të bazuar në rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga subjektet që mbartin detyrim, përfiton sipas rastit, mbrojtje të veçantë administrative.
6. Parandalimi i llojeve të veçanta të konfliktit rast për rast të interesit, do të realizohet si vijon:
- a. Çdo zyrtar në ushtrimin e kompetencave apo kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetë deklaram paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesave të tij private që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
  - b. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga eprori ose institucioni epror.
7. Kufizime të interesave private të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesave për çështje të veçanta do të jenë si vijon:
- a. Ndalimi i lidhjes së kontratave.
  - b. Mos pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit (prokurim, etj.).
  - b. Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale.

Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin në zbatim të ndalimeve të sipërshënuara përbëhet nga bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es, si dhe çdo person fizik ose juridik, i cili në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindura nga ky veprim.

## **Neni 12**

### **Rregjistri i konflikteve rast për rast të interesave**

Për rregjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të EKB, krijohet rregjistri me të njëjtin emër.

Rregjistri i konflikteve rast pas rast të interesave, administrohet nga Drejtori i Drejtorisë Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse dhe respekton formatin tip të miratuara nga ILDPKI.

## **Neni 13**

### **Njoftim i rregullores punonjësve dhe bërja publike e saj**

Rregullorja i bëhet e njohur çdo punonjësi të EKB-së nëpërmjet dërgimit si në postën elektronike edhe në faqen zyrtare të institucionit.

**Neni 14**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëhere me miratimin e saj.

**TIRANË, JANAR 2023**